

L I G J
Nr.7917, datë 13.4.1995

PËR KULLOTAT DHE LIVADHET

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka si objekt administrimin, kthimin ish-pronarëve, përdorimin me kritere të drejta, trajtimin, rritjen e aftësisë mbajtëse dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të kullotave dhe livadheve.

Neni 2

Kullotë dhe livadh është çdo lloj toke e mbuluar me bar ose shkurre që përdoret për kullotje e kositje bari për blegtorinë, por që nuk i përket fondit të tokës bujqësore, fondit pyjor, sipas gjendjes kadastrale më 1 gusht 1991, përveç atyre të ndryshuara sipas dispozitave në fuqi.

Kullotat dhe livadhet sipas periudhës së përdorimit klasifikohen në kullota verore dhe dimërore, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

KREU II
PRONËSIA, ADMINISTRIMI DHE TRAJTIMI I KULLOTAVE DHE LIVADHEVE

Neni 3

Kullotat dhe livadhet ndahen në:

Kullota dhe livadhe shtetërore, në përdorim të përgjithshëm dhe private (personale dhe në bashkëpronësi).

1. Kullotat dhe livadhet shtetërore janë në pronësi të shtetit dhe administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave nëpërmjet organeve të saj në rrethe.

2. Kullotat dhe livadhet shtetërore në përdorim të përgjithshëm që administrohen nga komuna e bashkia përkatëse dhe janë në përdorim të banorëve që ndodhen në juridiksionin e komunës dhe fshatit.

3. Kullotat dhe livadhet private (personale ose në bashkëpronësi).

Neni 4

Kullotat dhe livadhet që vërtetohen me dokumentacion të rregullt dhe kufi të qartë se kanë qenë pronë private (personale a në bashkëpronësi), u kthehen ish-pronarëve të tyre ose trashëgimtarëve. Këta gëzojnë të gjitha të drejtat e pronës private.

Neni 5

Kufijtë e kullotave ndërmjet fshatrave, komunës dhe rretheve njihen ato të vitit 1945. Në bazë të dokumentacionit kadastral, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave përcakton kufijtë e kullotave shtetërore, që miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Kullotat dhe livadhet shtetërore u jepen me qira personave fizikë e juridikë vendas, sipas kontratës së lidhur ndërmjet organeve vartëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave në rrethe dhe personave të interesuar sipas kritereve teknike të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 7

Veprat e ujit e objektet e ndryshme që lidhen me kullotën e që ndodhen në kullotat e livadhet private, u jepen në pronësi zotëruesve të kullotës a livadhit, duke paguar vleftën e tyre dhe mbi to vendosen barrat e nevojshme.

Veprat e ujit e objektet e ndryshme për kullotat e livadhet në përdorim të përgjithshëm, u jepen në përdorim komunave a bashkisë.

Neni 8

Ndryshimi i destinacionit për sipërfaqe të caktuar të kullotave dhe livadheve shtetërore, në përdorim të përgjithshëm dhe private bëhet me miratim:

- Për sipërfaqe deri në 10 ha nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave.
- Për sipërfaqet deri në 50 ha nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.
- Për sipërfaqet mbi 50 ha nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Ndërmarrja, komuna a bashkia është përgjegjëse për administrimin, përdorimin dhe trajtimin e kullotave dhe livadheve në përputhje me planet e mbarështimit dhe inventarizimit të kullotave e livadheve; mban fondin kullosor dhe kullotave dhe livadheve për çdo vit; përputh të dhënat me kadastrën e rrethit; bën periodikisht vlerësimin e aftësisë mbajtëse të kullotave dhe livadheve; organizon, ndjek e kontrollon përdorimin e kullotave dhe livadheve si dhe kryerjen e punimeve e ndërtimeve në to sipas projekteve të hartuara.

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe kullotave, nëpërmjet organeve të saj vartëse në rrethe, ka për detyrë të garantojë asistencën teknike kundrejt pagesës për hartimin e projekteve dhe zbatimin e tyre në kullotat që administrohen nga organet e pushtetit lokal dhe pronari privat.

Shteti financon në kullotat dhe livadhet që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave punimet për përmirësimin rrënjësor dhe ndërtimin e veprave që lidhen me shfrytëzimin racional të tyre (vepra uji, vepra ujitëse, ngrehina, rrugë etj.).

Neni 10

Personat privatë të cilët vetëm ose në bashkëpronësi disponojnë kullota dhe livadhe, të përfshihen në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të kullotave.

KREU III PËRDORIMI DHE TRAJTIMI I KULLOTAVE DHE LIVADHEVE

Neni 11

Për kullotat e livadhet shtetërore që jepen me qira, si dhe të objekteve që lidhen me kullotat, lidhet kontratë deri në 10 vjet me personat e interesuar.

Marrja me qira e kullotave, livadheve dhe veprave të ujit nga qiramarrësit bëhet mbi bazën e kontratës ndërmjet palëve.

Kriteret për vendosjen e tarifave të kullotjes caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Ndalohet kullotja e bagëtive në pjesë ku bëhen punime përmirësuese, në rezervatet natyrore, në ato farore dhe në parcelat eksperimentale.

Pjesët e kullotave dhe livadheve ku kryhen punime përmirësuese ose janë të degraduara, ndërmarrja përkatëse ose organi i pushtetit lokal i përjashton nga dhënia në përdorim për një periudhë kohe të caktuar në akt të veçantë të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit ose kryetarit të komunës a bashkisë.

Neni 13

Bimët mjekësore që gjenden në kullota dhe livadhe, mund të vilen nga persona fizikë e juridikë në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere.

Neni 14

Ngritja e kampingeve, qendrave dhe objekteve të tjera të lëvizshme në kullota e livadhe shtetërore dhe në përdorim të përgjithshëm bëhet me leje dhe vetëm në vendet e caktuara nga ndërmarrjet përkatëse ose pushteti lokal.

Neni 15

Përdorimi i sipërfaqes së tokës së kullotave dhe livadheve për qëllime të industrisë minerare, energjetike, si dhe nxjerrja e gurëve, zhavorrit, vendosja e furrave të gëlqeres dhe punimeve të tjera të kësaj natyre bëhet me leje të pushtetit lokal për kohën dhe vendin e duhur, sipas kritereve të nenit 8 të këtij ligji, kundrejt pagesës sipas tarifave në fuqi.

KREU IV MBROJTJA E KULLOTAVE DHE LIVADHEVE

Neni 16

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave dhe organet e pushtetit lokal të përgjigjen dhe marrin masa për mbarështimin e kullotave e livadheve dhe mbrojtjen e tyre nga dëmtimet.

Neni 17

Personat fizikë e juridikë që kanë kullota dhe livadheve, janë të detyruar të garantojnë mbrojtjen e tyre nga çdo lloj dëmtimi.

Burimet, veprat e ujit, ngrehinat, drurët, parcelat eksperimentale dhe zonat rezervate natyrore të kullotave dhe livadheve mbrohen sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 18

Ndalohet djegia e kullotave dhe livadheve. Në raste të veçanta mund të lejohet djegia e tyre me autorizim të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve.

Neni 19

Në rast zjarri në kullota dhe livadhe, ndërmarrjet përkatëse, organet e pushtetit lokal (komuna, bashki), pronarët privatë, forcat e armatosura, shkollat e çdo shtetas që ndodhen në afërsi, kanë për detyrë të njoftojnë për rënien e tij dhe të marrin pjesë me forcat e mjetet për shuarjen e zjarrit. Puna për shuarjen e zjarrit drejtohet nga ndërmarrja e pushtetit lokal dhe shpenzimet përballohen sipas administrimit të tyre.

Neni 20

Ndalohet çdo veprim që dëmton ose prish kullotat dhe livadhet, veprat e ujit, ngrehinat dhe instalime të ndryshme, si dhe çdo veprim që cenon ekuilibrin ekologjik në to.

KREU V KUNDËRVAJTJET

Neni 21

Shkelja e neneve 8, 11, 13, 14, 15, 18 e 20 të këtij ligji, kur sjell një dëm deri në 10.000 lekë, dënohet si kundërvajtje administrative me gjobë nga 1000 deri 10.000 lekë dhe me vjeljen e vlerës së dëmit.

Kur dëmi është mbi 10.000 lekë, personi fajtor përgjigjet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 22

Për shkeljen e dispozitave të parashikuara në nenin 21, mbahet procesverbali përkatës nga nëpunësi i ngarkuar i ndërmarrjes përkatëse ose i pushtetit lokal (komunë, bashki) dhe privat.

Neni 23

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative në kullota e livadhe bëhet nga një komision prej jo më pak se tre vetash pranë ndërmarrjes përkatëse dhe organeve të pushtetit lokal (komunë a bashki), përbërja e të cilit caktohet nga drejtori i ndërmarrjes ose kryetari i komunës a bashkisë.

Kundër vendimit të dënimit kundërvajtësi ankohet, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes, në gjykatën e rrethit.

Gjoha dhe shpërblimi i dëmit duhet të bëhet vullnetarisht brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të formës së prerë. Pas kalimit të këtij afati zbatohen kriteret e përcaktuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative

Neni 24

Dëmshpërblimet e dëmeve të shkaktuara në kullota dhe livadhe caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 25

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 26

Ish-pronarët ose trashëgimtarët e kullotave dhe livadheve duhet të paraqesin në komisionet shtetërore të kthimit dhe kompensimit të pronave në rreth dokumentet e pronësisë brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Me kalimin e këtij afati dokumentet nuk pranohen.

Neni 27

Kundër vendimit të komisionit në rreth mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit.

KREU VI DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 28

Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 9.5.1981 dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1080, datë 27.4.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha